

Emri i Lëndës : Prokurim Publik							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 204	B	Pranverë	3.00	0.00	0.00	3.00	4.00
Lektori	Ada Güven, PhD						
Asistenti	Albana Laknori, Msc						
Gjuha e kursit	Shqip						
Niveli i lëndës	Program i Integruar						
Përshkrimi	Lënda “Prokurimi Publik” studion mënyrën e organizimit dhe rregullat bazë të funksionimit të Prokurimit Publik, sipas kuptimit të këtij ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili përcakton rregullat për procedurat e prokurimit nga autoritetet dhe entet kontraktore për kontratat publike dhe konkurset e projektimit. Prokurimi, sipas kuptimit të këtij ligji, është blerja e punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet e mallrave ose shërbimet përdoren ose jo për qëllime publike. Kjo lëndë studion elementet bazë të këtij ligji duke dhënë koncepte të detajuara mbi mënyrën e veprimit, organizimin e institucioneve si Agjencia e Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik etj. Gjithashtu një vend të veçantë në studimin e kësaj lënde zë hulumtimi i disa prej direktivave kryesore të BE me qëllim përafrimine legjislativ shqiptar me acquis e BE-së, duke transpozuar ose adaptuar direktivat specifike, të cilët mbulojnë procedurat e prokurimit në sektorin klasik, sektoral dhe direktivat e rishikimit administrative.						
Objektivat	“Prokurimi Publik” merr përsipër të japë njohuri të plota mbi prokurimet, Koncesionet/Parneritetet Publike Private ankandet si edhe procedurat për dhënie e Lejeve Minerare. Në veçanti lënda jep informacion të detajuar mbi disa prej institucioneve më të rëndësishme në fushën e prokurimit publik duke patur si qëllim të njohë studentët me parimet bazë të formimit, veprimtarisë dhe problemeve të ndryshme administrative, që ato shfaqin në praktikë. Qëllim tjetër i rëndësishëm i kësaj lëndë është njohja e studentëve me parimet bazë të këtij ligji dhe zgjidhjen që u bëhet nga praktika administrative e gjyqësore mosmarrëveshjeve administrative që lindin në kuadër të zbatimit të tij. Lënda synon që të aftësojë studentët të bëjnë punime me nivel të lartë shkencor (ese, detyra kursi, projekte). Të nxitet të vështrohet kritik dhe akti i korrektimit ligjor në rastet e shmangieve nga standardet juridike, etj.						
Konceptet Kryesore	1. Kontrata publike 2. Ankandi publik 3. Prokurim publik 4. Hetimi administrativ 5. Koncesione 6. PPP (Partneriteti Publik Privat)						
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Hyrje në Legjislacionin e Prokurimit Publik; Historiku i prokurimit publik në Shqipëri;; Evoluimi i tij nga krijimi deri në ditët e sotme. Hyrje e përgjithshme mbi kontratat publike, do të jepen elementet bazë dhe kuptimi i kontratave publike në një këndvështrim të përgjithshëm. (Ligji për Prokurimin Publik)						
2	Konceptet dhe parimet e prokurimit publik. Shpjegimi i disa koncepteve kryesore të cilat janë fjalët kyce të kësaj lënde dhe që do i ndihmojë studnetët në kuptimin e temave të tjera pasardhëse. (Ligji për Prokurimin Publik)						
3	Elementët e procesit të prokurimit publik, nevoja për një mall, shërbim, apo punë, fondi publik në dispozicion të Autoritetit Kontraktor për këtë qëllim; Roli dhe rëndësia e parimeve në procesin e prokurimit publik; Rastet e shkeljes së parimeve të prokurimit publik. (Ligji për Prokurimin Publik dhe Udhëzues Për mbështetjen dhe forcimin e sistemeve shqiptare të prokurimit publik, koncesioneve dhe ankandeve publike						

4	Konflikti i interesave në prokurimin publik ; Llojet e konfliktit të interesave; Rasti i konflikteve të anëtarëve të njësisë së prokurimit, të anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të titullarit të AK-së, etj. Rastet e konfliktit të interesave të operatorëve ekonomikë; Parashikimet ligjore për zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave. (Ligji për Prokurimin Publik dhe Udhëzues Për mbështetjen dhe forcimin e sistemeve shqiptare të prokurimit publik, koncesioneve dhe ankandeve publike)
5	Rëndësia e identifikimit të nevojave që do të realizohen nëpërmjet procesit të prokurimit publik; ekzistenca e nevojës, si element kyç në legjitimimin e procesit të prokurimit; ndikimi i drejtëpërdrejtë i identifikimit të nevojave, në realizimin me sukses, ose jo të kontratës publike që do të lidhet në përfundim të procesit të prokurimit; identifikimi dhe planifikimi i nevojave, si pjesë e planifikimit buxhetor të Autoritetit Kontraktor. (Ligji për Prokurimin Publik dhe Udhëzues Për mbështetjen dhe forcimin e sistemeve shqiptare të prokurimit publik, koncesioneve dhe ankandeve publike)
6	Specifikimet teknike, kriteret për kualifikim dhe kriteret e përzgjedhjes së fituesit; Përgatitja e specifikimeve, -Parimet që duhet të mbahen parasysh në përgatitjen e specifikimeve teknike, Karakteristikat e specifikimeve teknike si dhe roli i tyre në një procedurë prokurimi, etj. (Ligji për Prokurimin Publik dhe Udhëzues Për mbështetjen dhe forcimin e sistemeve shqiptare të prokurimit publik, koncesioneve dhe ankandeve publike)
7	Llojet e procedurave të prokurimit publik sipas legjislacionit shqiptar; Procedurat e prokurimit publik; Rastet e përzgjedhjes së tyre; (Ligji për Prokurimin Publik dhe Udhëzues Për mbështetjen dhe forcimin e sistemeve shqiptare të prokurimit publik, koncesioneve dhe ankandeve publike)
8	Gjysmëfinal
9	Zhvillimi i procesit të prokurimit publik ; Hapat që duhet të ndiqen gjatë procesit të prokurimit; Roli dhe përgjegjësia e secilit prej funksioneve brenda AK, gjatë ciklit të prokurimit; Përgjegjësia e AK-së në administrimin e këtij procesi. (Ligji për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat, nr. 125/2013 ndryshuar me ligjin nr. 88/2014)
10	Sistemi i rishikimit në prokurimin publik; E drejta për ankim në procesin e prokurimit publik; Shkallët e ankimit. (Ligji për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat, nr. 125/2013 ndryshuar me ligjin nr. 88/2014)
11	Sistemi i prokurimit elektronik në Shqipëri; Mënyra e prokurimit nëpërmjet sistemit elektronik, Roli i APP-së dhe AK-ve në sistemin e prokurimit elektronik, Integriteti dhe gjurmueshmëria e të dhënave në sistemin e prokurimit elektronik, Përparesitë e përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik etj (Ligji për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat, nr. 125/2013 ndryshuar me ligjin nr. 88/2014)
12	Menaxhimi i kontratës; Roli i Autoritetit Kontraktor në menaxhimin e kontratës;; Lidhja midis kontratës dhe procesit të prokurimit; Mundësia e ndryshimit të kushteve të kontratës publike, pas lidhjes së saj; Rëndësia e mirëmenaxhimit të kontratës publike. (Ligji për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat, nr. 125/2013 ndryshuar me ligjin nr. 88/2014)
13	Regjimi i Komisionit Evropian për Prokurimin Publik dhe situata aktuale dhe ndryshimet e nevojshme legjislative për përafrimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimit publik shqiptar me atë evropian 3. (Christopher Bovis (2007) EU Public Procurement Law, Edward Edgar Publishing, London)
14	Direktivat e BE-së për prokurimin publik; Rëndësia e rregullimit të prokurimit publik sipas Direktivave përkatëse të BE-së. / Detyrimet e MSA për prokurimin publik, Ndryshimet e nevojshme në legjislacionin shqiptar të prokurimit, etj. (Christopher Bovis (2007) EU Public Procurement Law, Edward Edgar Publishing, London)
15	Praktikë gjyqësore mbi kontratat publike
16	Final Exam

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• Ligji për Prokurimin Publik, nr. 9643/2007 ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 • APP (2012) Udhëzues Për mbështetjen dhe forcimin e sistemeve shqiptare të prokurimit publik, koncesioneve dhe ankandeve publike, APP, Tiranë • Christopher Bovis (2006) EC Public Procurement: Case Law and Regulation, OUP, Oxford. • Christopher Bovis (2007) EU Public Procurement Law, Edward Edgar Publishing, London
Referenca të tjera	• Vendim Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017 • Ligji për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat, nr. 125/2013 ndryshuar me ligjin nr. 88/2014 • Ligji për Ankandin Publik, nr. 9874/2008 ndryshuar me ligjin nr. 10346/2010
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Fitimi i njohurive rreth çështjeve dhe problematikave të fushës së prokurimit Publik.
2	Përcaktimi i ngjarjeve dhe temave komplekse, nëpërmjet zhvillimit të diskutimeve dhe bërjes së sugjerimeve të reja në përputhje me hulumtimet e fushës
3	Ne perfundim te lendes studentet do jene te afte te ndjekin zhvillimet e procesit te prokurimit publik dhe ankimet ne rastet e duhura.
4	Studentet do te fitojne njohuri ne lidhje me konfliktin e interesit ne prokurimin publik, llojet e konfliktit te interesave.
5	Studentet do te fitojne njohuri ne lidhje me regjimin e Komisionit Evropian për Prokurimin Publik dhe Direktivat e BE-së për prokurimin publik.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	50	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	2	2
Provimi final	1	2	2
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			94
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			3.76
ECTS			4.00